

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	84 votat e mazhorancës si sinjal politik për sponsorët e flamingove
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/84-votat-e-mazhorances-si-sinjal-politik-per-sponsor-et-e-flamingove-i586937
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 16:17:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 16:12:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a7903c9e401744cf950f026c7b57b3e7895d57299723461d3afbe0f33f80c78d
TEKSTI	fb11e6840c064d84e06474bb34228e79f1500ec21c7647ddcfe1799d03b00e56
PAMJA	d7f3bd6b7819fe646c7707fd4fde2c20ad1e93cd8a117acb58cc518f6aef610f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3119b5b34d60bab3f5b6830126e4616945b21431b3ef1ffdb704ffa3b39f9af8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	01dec896a9f5048ec789d11efc6a4c6ac149c2dbc9d9f31c517f24c69c93634b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3119b5b34d60bab3f5b6830126e4616945b21431b3ef1ffdb704ffa3b39f9af8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

84 votat e mazhorances si sinjal politik per sponsorët e flamingoveGrabitet apartamenti i kardinalit Ernest Simoni ne FIRENCE, hajdutet moren 30 mije euro e sende me v fundit

84 votat e mazhorancës si sinjal politik për sponsorët e flamingove

TemA

18 Shtator 2026, 18:12Politika TEMA



Nga Ylli Pata

Marrja e 84 votave nga mazhoranca për ligjin e pagave të magistratave madje edhe për emërimin e Ervin Demos si Ministër i Brendshëm mund të ishte një akt normal në një situatë të qetë.

Por pas një tallazi të gjatë politik që erdhi si një revolucion i vërtetë politik ku së pari i hoqi mazhorancës një deputete, siç ishte Marjana e Fukagjinit, si dhe qëndrime të tjera nga deputetë të kësaj mazhoranca, numrat e konfirmuar janë një sinjal.

Një sinjal që natyrisht nuk kanë aq shumë lidhje me një analizë që lidhet me fuqinë e Edi Ramës si drejtues i mazhorancës që rriti votat politike në 2025-n. Por si personazh që vjen pas revolucionit të flamingove, i cili ishte një operacion për ta rrëzuar këtë mazhorancë. 84 votat e arritur për ligjin e pagave të magistratëve është një sinjal politik, që siç u duk Edi Rama donte tu tregonte mbështetësve e financuesve të flamingove për objektivin e arritur pak a shumë.

Ndërkaq, ky sinjal që duket se donte të lëshonte Edi Rama, vjen në një kërcitje më të madhe për sheshin tjetër atë të opozitës.

Shesh, që me revolucionin e flamingove është zgjeruar në formë, por jo në përmbatje. Pasi edhe kjo opozitë e re, që natyrisht nisi si operacion kontestimi, për më shumë se 100 dite nuk ka prodhuar një fytyrë reale të një rruge të re.

Një rrugë që mund të vijë si ide, si koncept, si grup drejtues apo edhe si një notification siç është edhe moda. Jo, synimi ka qenë të bllokojmë e rrëzojmë mazhorancën. Ku ikja e Marjana Koçekut u duk se ishte sinjali më i fortë. Por me kalimin e tre muajve, ai sinjal ka mbetur aty.

Edi Rama dhe mazhoranca, duket se e ka përballur fazën e tcunamit, por kjo politikisht, së paku për publikun apo pritshmërinë e tij nuk se ka rëndësi. Pasi ai është mësuar me këtë skenar. Njerëzit duhen të tijnë “dhëndrin” e ri të vendit, ose së paku të krijojnë një imagjinatë se si është ideja e alternativës së ndryshimit. Kjo nuk ka ardhur për shumë arsye, sepse kanë dashur që të zbatojnë planin A para B, pa pasur, ose pa e treguar planin e ri. Kjo taktikë normalisht edhe mund të ketë arsye, pasi siç është bërë tashmë si modë: ja prish Rama.

Por tregimi i skenarit të ri pas rrëzimit të kësaj mazhorance, apo paraqitjes së alternativës së rivalit politik të Ramës është gjëja më normale e mundshme.

Në këtë diapazon ka mjaft mundësi për të sjellë alternativa apo për të hapur një mundësi promovimi. Kjo nuk ka ndodhur sepse kemi të bëjmë me një lëvizje që nuk ka menduar për të ardhmen, apo shkurt nuk i është urdhëruar e ardhmja, por e sotmja. Ndaj sinjali i 84 votave është një mesazh i mazhorancës për sponsorin e flamingove, që nuk është në Shqipëri, po larg, aty ku nesër shkon dhe Edi Rama.

TemA

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Hoxha takim me përfaqësuesin e ri të OBSH-së në Shqipëri: Partneritet për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimit të kujdesit shëndetësor](#)

16:30 Politika

[Reagojnë avokatët e huaj të Veliajt, Kasowitz: Vendimi i Gjykatës së Lartë është kafkian, vë në provë nëse kontrolli kushtetues ka fuqi praktike](#)

14:00 Politika / 17 komente

Debati për pagat e magistratëve, Rama u drejtohet drejtuesve të gjyqësorit: Të ulemi në një tryezë pune, kërkojmë një zgjidhje të qëndrueshme afatgjatë

13:25 Politika / 14 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.